



Datë: 15.05.2026

A.nr.1958/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, më Avdyll Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1958/2025, të datës 27.11.2025, të parashtruar nga ankuesi K.H, nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Ministrisë së Financave, Punës dhe Trasfereve, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 15.05.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1958/2025 e datës 27.11.2025, e parashtruar nga ankuesi K .H.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr. 18-2/2025, i datës 28.10.2025 (numër protokolli 538-2/23/25 i datës 29.10.2025), i Ministrit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, si dhe Rekomandimi nr.05/2024, i datës 06.10.2025, i Komisionit për Kushte të Tregut.

A r s y e t i m

Ankuesi K.H, (tutje referuar vetëm ankuesi), më datë 27.11.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 18-2/2025 të datës 28.10.2025, të Ministrit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (tutje referuar vetëm MFPT), ndërsa kjo e ka dërguar përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 7609/2025 e datës 27.11.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emailin e datës 22.09.2025 nga ankuesi për Kryesuesin e Komisionit për Kushte të Tregut të Punës; Rekomandimin me Nr.05/2025 të datës 06.10.2025 të Komisionit për Kushte të Tregut të Punës; Vendimin me Nr.18-1/2025 të datës 08.10.2025 të Ministrit të MFPT-së; Emailin e datës 10.10.2025 nga udhëheqësja e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Ekonomisë për Kryesuesin e Komisionit për Kushte të Tregut të Punës; Emailin e datës 09.10.2025 dhe 08.10.2025 nga A.J për ankuesin; Emailin e datës 08.10.2025 nga ankuesi për A.J; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punës për ankuesin datës 05.12.2022 dhe 23.01.2022; Emailin e datës 13.10.2025 nga F.S për F.K, AJ dhe Q.B; Vendimin e datës 01.12.2022 për lirim nga detyra për ankuesin; Emailin e datës 10.11.2022 nga F.S për F.C; Emailin e datës 03.12.2022 nga F.C për F.S; Rekomandimin me Nr. 06/2025 të datës 28.10.2025 nga Komisioni për Kushte të Tregut të Punës; Vendimin me Nr. 28-2/2025 të datës 29.10.2025 të Ministrit të MFPT-së; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 04.12.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 09.12.2025; Akt Emërimit e datës 03.09.2025; Certifikatën e lëshuar nga Universiteti i Maastricht.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesi, është e pabazuar, *sepse:*

Gjendja e çështjes

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton:

-Ankuesi ka qenë i punësuar në Zyrën e Kryeministrit në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Administratë Publike dhe Sundim të Ligjit, ndërsa, i njëjti me vet dëshirë (më dorëheqje) ka shkëputur marrëdhënien e punës në shërbim civil, rrjedhimisht sipas Vendimit Nr.118/2022, të datës 01.12.2023, të Udhëheqëses së Burime Njerëzore të Zyrës së Kryeministrit, marrëdhënia e punës së ankuesit ka përfunduar më datë 01.12.2022.

-Ankuesi pas procesit të rekrutimit, më Aktin e Emërimit nr.114/2025 të datës 03.09.2025, është emëruar në pozitën Drejtor i Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave, në Ministrinë e Ekonomisë duke filluar nga data 08.09.2025.

-Ministria e Ekonomisë më datë 22.09.2025, i është drejtuar Komisionit për Kushte të Tregut të Punës në MFPT, me kërkesë për njohje të shtesës për kushteve të tregut të punës lidhur me ankuesin pasi që i njëjti ka qenë bursist nga skema e profesionistëve të rinj rundi 6.

-Komisioni për Kushte të Tregut të Punës në MFPT, më datë 06.10.2025 ka nxjerr Rekomandimin me Nr.05/2025, me të cilin ka konstatuar se duke qenë se ankuesi ka qenë pjesë e programit të bashkëfinancimit “Skema e Profesionistëve të Rinj” plotëson të gjitha kërkesat ligjore për të përfituar shtesën prej 250 Euro, e si rezultat i këtij fekondimi Ministri i MFPT-së, më datë 06.10.2025, ka nxjerr Vendim me Nr. 18-1/2025, me numër protokolli 5381-1/23/25 me të cilin ka aprovuar rekomandimin e Komisionit për Kushte të Tregut të Punës , duke ja njohur ankuesit shtesën prej 250 Euro.

-Me qëllim të zbatimit të këtij vendimi, Kryesuesi i Komisionit për Kushte të Tregut të Punës, përmes emailit të datës 08.10.2025, ka kërkuar nga ankuesi të dërgohet vlerësimi i fundit i performancës në shërbimin civil, ndërsa ankuesi më datë 08.10.2025 ka dorëzuar vlerësimin e performancës, mirëpo në vijim të komunikimit Udhëheqësja e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Ekonomisë më datë 10.10.2025 ka njoftuar kryesuesin e Komisionit për Kushte të Tregut të Punës se ankuesi ka vlerësim të vitit 2022 me notën një (1).

-Si rezultat i kësaj, Komisioni për Kushte të Tregut të Punës, më datë 28.10.2025, ka nxjerr Rekomandimin me Nr. 06/2025, me të cilin konstaton edhe përkundër faktit që nuk ka kompetencë të kryej vlefshmërinë e vlerësimit të vitit 2022 i dhënë pas dorëheqjes, vlerëson se ankuesi nuk plotëson kriterin ligjor të paraparë me nenin 7 paragrafi 2.3 të Rregullores (MFPT) Nr. 02/2023 për Shtesën për Kushte të Tregut të Punës, duke rekomanduar që të shfuqizohet Vendimit me Nr. 18-1/2025 i Ministrit të MFPT-së, ndërsa Ministri i MFPT-së, më datë 28.10.2025 ka nxjerr Vendimin Nr.18-2/2025 me numër protokolli 538-2/23/25, me të cilin ka aprovuar rekomandimin e Komisionit për Kushte të Tregut të Punës të datës 28.10.2025, duke anuluar Vendimin me Nr. 18-1/2025 të datës 08.10.2025.

Pretendimet ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton Vendimin Nr. 18-2/2025 të datës 28.10.2025, të Ministrit të MFPT-së, më pretendimin se vlerësimi i fundit është ai i vitit 2021 i cili është i ligjshëm, ndërsa, vlerësimi i rezultateve të punës i vitit 2022 është bërë pas dorëheqjes sime nga pozita dhe është plotësisht i paligjshëm, dhe këtë e ka konfirmuar edhe nga Njësia e Burimeve Njerëzore e Zyrës së Kryeministrit, andaj konsideron që vendimi i kundërshtuar me ankesë duhet anuluar, dhe të lihet në fuqi vendimi paraprak me të cilin i është njohur shtesa prej 250 Euro.

Vlerësimi i Kolegjit

Lidhur më bazushmërinë e pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit iu referua bazës ligjore në fuqi që rregullon çështjen e shtesave përtej pagës bazë, me theks:

I. Ligji Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik

Nenit 22, [Shtesat] më të cilin përcaktohet: “1. Shtesat që mund përfitohen në bazë të këtij ligji janë: 1.1. shtesa e veçantë për të zgjedhurat/it; **1.2. shtesa për kushte tregu të punës;** 1.3. shtesa e performancës; 1.4. shtesa për kushte specifike të punës; 1.5. shtesa për punën pa orar të paracaktuar; 1.6. shtesa për vëllimin e punës; 1.7. shtesa për licencë të avancuar për nëpunësen/in e arsimit para universitar; 1.8. shtesa për nëpunësen/in e sistemit shëndetësor; 1.9. shtesa e performancës për krijuesen/in dhe performuesen/in e artit dhe kulturës; 1.10. shtesa funksionale”,

Neni 24 [Shtesa për kushte të tregut të punës] 1. Shtesa për kushte të tregut të punës përfitohet për profesione të nevojshme, në pozita të caktuara profesionale deficitare të shërbimit civil dhe shërbimit publik, ku rekrutimi apo mbajtja e nëpunësve/ve në këto profesione dhe/apo pozita objektivisht është e pamundur. 2. Fondet e përdorura në çdo institucion për shtesën për kushte tregu të punës, nuk mund të jenë më të larta se 0.5% e fondeve totale të përdorura nga institucioni, për pagën bazë të zyrtareve/ëve në të njëjtin vit fiskal. 3. Për qëllim të zbatimit të këtij neni, Qeveria e Republikës së Kosovës do të

trajtohet si një (1) organizatë buxhetore. 4. Profesionet përkatëse për të cilat përfitohet shtesa për kushtet e tregut të punës për nëpunësen/in civile dhe nëpunësen/in e/i shërbimit publik, vlera dhe procedura për përfitimin e saj miratohen me akt nënligjor nga ministria përgjegjëse për financa. Përfitimi i shtesës për kushtet e tregut për nëpunës të shërbimit civil rishikohet të paktën çdo tre (3) vjet. 5. Profesionet përkatëse për të cilat përfitohet shtesa për kushtet e tregut, vlera dhe procedura për përfitimin e saj për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese rregullohet me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të institucioneve. Përfitimi i shtesës për kushtet e tregut rishikohet të paktën çdo tre (3) vjet nga organet kompetente të këtyre institucioneve.

II. Rregulloren (MFPT) Nr.02/2023 për Shtesat për Kushte të Tregut të Punës:

*Neni 4: Shtesa për kushte të tregut të punës përfitohet për pozita të caktuara deficitare dhe të rralla të shërbimit civil dhe shërbimit publik, ku rekrutimi apo mbajtja e nëpunësve në këto profesione dhe/apo pozita objektivisht është e pamundur ose ka vështirësi të konsiderueshme në rekrutimin ose mbajtjen e personelit të kualifikuar të atyre pozitave. 2. Shtesa për kushte të tregut të punës mund të përfitohet kur plotësohen kumulativisht kriteret e përgjithshme dhe kriteret e veçanta, kur kriteret e veçanta aplikohen për secilin profesion deficitar. 3. Kriteret e përgjithshme, janë si në vijim: 3.1. nëpunësi civil apo nëpunësi i shërbimit publik është i punësuar në pozita specifike profesionale, drejtuese, si dhe specialistët; 3.2. rekrutimi apo mbajtja e nëpunësve në këto pozita specifike për shkak të kualifikimeve të mbajtësit të pozitës krijon vështirësi për shkak se tregu privat ofron paga dukshëm më të larta se sektori publik; 3.3. përpjekjet për rekrutimin e personelit me pagë të Shërbimit Civil kanë dështuar dhe/ose shkalla e dorëheqjeve krijon probleme në funksionimin e rregullt të njërive administrative. 4. Profesionet për të cilat mund të përfitohet shtesa për kushte të tregut të punës janë: 4.1.profesionet deficitare në fushën e teknologjisë informative; 4.2. profesionet deficitare në fushën e aviacionit dhe navigimit ajror; **4.3.profesionet nga programet studimore të financuara ose bashkë-financuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës;** 4.4.specialistët shëndetësor në profesione deficitare, ashtu siç përcaktohen nga ministria përkatëse për shëndetësi; si dhe **4.5.pozita tjera të caktuara profesionale deficitare të shërbimit civil dhe shërbimit publik, ku rekrutimi apo mbajtja e nëpunësve/ve me pagat e rregullta në këto profesione dhe/apo pozita objektivisht është e pamundur**”,*

Neni 7: 1. Të punësuarit që kanë kryer studimet e nivelit të dytë të arsimit të lartë në programet studimore të financuara apo të bashkëfinancuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës kanë të drejtë të përfitojnë shtesë për kushte të tregut të punës. 2. Për të përfituar këtë shtesë, duhet të plotësohen kumulativisht kushtet si në vijim: 2.1. programi i studimeve të nivelit të dytë të arsimit të lartë të jetë i financiar ose bashkë-financuar nga Qeveria e Kosovës; 2.2.të kenë të përfunduar studimet e nivelit të dytë të arsimit të lartë në universitete jashtë vendit; 2.3. të kenë vlerësim të performancës mbi notën “mirë”; dhe 2.4.të mos ketë masë disiplinore aktive për shkelje të rënda...”.

Andaj, bazuar në kuadrin ligjor si më sipër, Kolegji vlerëson se akti i kontestuar është nxjerrë në pajtim me dispozitat materiale, mbi arsyet se ankuesi me datë 01.12.2022 ka humbur statusin e nëpunësit civil si pasojë e dorëheqjes nga shqyrtimi civil, ndërsa, i njëjti me datë 08.09.2025, serish ka rifituar statusin e nëpunësit civil, kështu që përmbushja e kriterit lidhur me vlerësimin e performancës në rastin konkret është e pamundur, sepse, vlerësimi i performancës i referohet vitit të fundit, kështu që ankuesi duke qenë se ka filluar marrëdhënien e punës në shërbim civil më datë 08.09.2025, atëherë, njohja e shtesës për profesionet nga programet studimore të financuara ose bashkë-financuara nga Qeveria e Republikës së Kosovë vije në zbatim vetëm nën kushtin pasi që ankuesi të ketë vlerësim të mirë të përforcues në punë për periudhën një vjeçare, kështu që, mbi këto fakte e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.1958/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit K.H;
- Ministrit të Ministrisë për Financa;
- Komisionit për Kushte të Tregut të Punës në Ministrinë e Financave;
- Njësisë së Personelit të Ministrisë së Ekonomisë;
- Arkivit të KPMSHCK-së